

VENDIM
Nr.405, datë 14.6.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon.

“3. a) Paga e drejtorit të Policisë së Ndërtimit njësohet me pagën e nëpunësit civil, të kategorisë II-a, në ministri, sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. b) Paga e zëvendës drejtorit të Policisë së Ndërtimit njësohet me pagën e nëpunësit civil, të kategorisë II-b, në ministri, sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave të ndryshuar.

3. c) Tabelat nr.2, “Pasqyra e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit, në qendër” dhe “Pasqyra e pagave për punonjësit e degëve të Policisë së Ndërtimit, në rrethe”, zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.”.

- Në fund të pikës 4, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Drejtori dhe zëvendës drejtori i Policisë së Ndërtimit nuk përfitojnë shtesë page për natyrë të veçantë pune dhe shtesë page për vështirësi shërbimi.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Tabela nr.2

PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË NDËRTIMIT
NË QENDËR

Nr.	Emërtimi	Klasa	Paga në lekë
1	Drejtor		II-a
2	Zëvendës drejtor		II-b
3	Kryetar dege	XXII	33600
4	Shef sektori	XXII	33600
5	Kryetar Grupi Gatishmërie	XXII	33600
6	Specialistë	XXI	31200
7	Shofer	IX	18960
8	Punonjës Grupi Gatishmërie	XIX	26160

9	Arkivist.Daktilografist.Protokollist	VI	16680
10	Magazinier	VI	16680
11	Sekretare, daktilografiste	VI	16680
12	Punonjës shërbimi	III	14500
13	Pastruese	I	14000

Tabela nr.2

PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË NDËRTIMIT
NË RRETHE

Nr	Emërtimi	Klasa	Paga në lekë
1	Kryetar dege K1	XXII	33600
2	Kryetar dege K2	XXI	31200
3	Shef sektori	XXI	31200
4	Specialist i lartë	XX	28200
5	Specialist i mesëm	VIII	17400
6	Kryetar Grupi Gatishmërie	XXI	31200
7	Specialist Grupi Gatishmërie	XIX	26160
8	Arkivist-Protokollist	VI	16680
9	Shofer	IX	18960